



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI,
TË MBAJTUR MË 23 MARS 2015**

**SA JAVNE DEBATE KOMISIJE ZA EKONOMSKI RAZVOJ,
INFRASTRUKTURU, TRGOVINU I INDUSTRIJU, ODRŽANE 23. MARTA
2015. GODINE**

**MARS
2015**

Dëgjimin publik e drejton deputeti Besim Beqaj kryesues i Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për investimet e huaja - Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

KRYESUESI: Mirë se keni ardhur të gjithë!

Ne sot jemi këtu për dëgjimin publik lidhur me mbikëqyrjen e Ligjit për investime të huaja.

Më lejoni të ju përshëndes zëvendësministrin e Tregtisë me stafin e tij.

Të përshëndes deputetët të grupit punues po edhe deputetët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri të cilët na janë bashkangjitur sot.

Siç e dini ne afër një muaj kemi fillua procedurën për mbikëqyrjen e Ligjit për investime të huaja. Me qëllim që të kuptojmë nivelin e zbatimit të këtij ligji, të kuptojmë se në çfarë gjendje jemi me investime të huaja në Kosovë dhe me investimet vendore. Njëkohësisht të kuptojmë drejtpërdrejtë nga tatimet që kemi pasur me komunitetin e biznesit për procedurat, burokracitë, problemet respektivisht masat të cilat duhet të ndërmerren në drejtim të përmirësimit të këtij ligji. Ne konform vendimit për themelimin e ligjit, kemi fillua me analizimin e bazës legjislative respektivisht kolizionit ligjor nëse ka kolizion ligjor me ligje tjera të zbatueshme të cilat e prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë investimin e huaj.

Pastaj, kemi takuar institucionet përgjegjëse për tërheqjen e investimeve të huaja nga Ministria për Tregti dhe Industri kemi takuar .. respektivisht Zyrën ligjore të ministrisë e cila është dashtë të na japë shpjegimet e veta lidhur me funksionalitetin dhe potencialisht kolizionet ligjore të cilat mund të dalin. Në ndërkohë kemi bërë disa vizita në terren, kemi takuar fillimisht Aleancën Kosovare të Biznesit, ku kemi takuar një numër të investitorëve potencial dhe kemi marrë nga ata edhe aspektin e funksionimit të ligjit por edhe aspektin administrativ procedural të realizimit të investimeve në Republikën e Kosovës.

Unë shpresoj se sot në këtë debat do të pasurohet edhe më tutje e them përmbajtja e rekomandimeve të cilat duhet të dalin dhe duhet t'i shkojnë seancës për të përmirësuar ambientin për të bërë biznes por njëkohësisht edhe për të tërhequr investimet e huaja. Aty kemi marrë edhe statistika të ecurisë së investimeve të huaja, arsyeshmërisë, kemi trajtuar problemin pse kemi investime të cilat gjatë këtyre ditëve është bërë një farë norme e tendencës për t'u larguar nga vendi. Cilat janë arsyet për të cilën po flasim?

Në ndërkohë kemi takuar edhe Odën Ekonomike të Kosovës, gjithashtu me afaristë, anëtarë të saj. Kemi takuar Odën Ekonomike të Austrisë, Odën Ekonomike Amerikane për të kuptuar në detaje funksionimin e ligjit dhe procedurat. Do të ju them që në përgjithësi të gjithë kanë pasur një mendim se ligji si ligj i tillë është relativisht ligj i mirë, ka pasur vërejtje lidhur me emrin e ligjit, pse të thirret ligj për investime të huaja dhe jo Ligj për investime. Këtë e themi në diskutim e kemi nda edhe ne deputetët me ta, duke filluar edhe nga deputeti Grainca edhe unë personalisht të gjithë deputetët anëtarë të Komisionit.

Pastaj, në këndvështrimin e funksionalitetit të ligjit ka vërejtje të cilat unë besoj që sot do t'i shohisim edhe më mirë në mënyrë që të kuptojmë se në çfarë rrethanash dhe në çfarë mekanizmi ne do të veprojmë.

Pra, ligji është tanimë në diskutim dhe mund të hapet edhe për amendamente qoftë në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, edhe ne si deputetë kemi të drejtë të fillojmë procedurën e amendamentimit të këtij ligji. Jemi munduar që të bëjmë identifikimin e rasteve konkrete lidhur me problemet dhe problemet dhe identifikimin e problemeve. Duhet të ju them që problemet të cilat ne i kemi identifikuar në parim janë prej perceptimeve të cilat janë të gabueshme, burokracinë që është ekstrem problem i madh, energjinë, sundimin e ligjit dhe politika fiskale kështu në përgjithësi dhe pastaj sigurisht që të gjitha këto çështje kanë një sërë rekomandimesh brenda vetes.

Pra, sot jemi këtu për dëgjim publik, unë i ftoj të gjithë juve që të jeni sa më të hapur, kemi këtu edhe drejtorin e doganave për informacionin tuaj ne kemi ftuar edhe Ministrin e Punëve të Brendshme Departamentin e Migracionit për të cilin ka pasur goxha raste të problemeve të cilat janë paraqitur nga ana e biznesit. Kemi ftuar organizatat joqeveritare që merren me zhvillimin ekonomik, dhe i përshëndes të gjithë të pranishmit. Kemi ftuar odat ekonomike dhe kemi ftuar investorët individual potencial të cilët kanë në plan apo kanë bërë investim dhe të cilët kanë nevojë të flasin lidhur me përvojat e tyre respektivisht rekomandimet e tyre sa i përket investimeve.

Të kuptohemi që investorët individual janë të thirrur përmes asociacioneve të biznesit pra ata kanë qenë pikat referente dhe ne nuk kemi bërë ftesë individuale për asnjë nga këta investorë por ja kemi lënë që këtë çështje ta bëjnë odat ekonomike respektivisht asociacionet e biznesit.

Me qenë se jemi në dëgjim publik dhe procesverbale do të mbahet jo me stafin është transkript, ju kisha kërkuar pavarësisht që ne njihemi gati po thuaj se të gjithë me njëri tjetrin për hirrë të transkriptit dhe të procedurave është mirë që fillimisht të prezantoheni dhe pastaj të jepni rekomandimet, vërejtjet apo sugjerimet tuaja.

Edhe një herë ju falënderoj për bashkëpunimin gjatë këtyre ditëve. Në emër tim dhe në emër të Komisionit në përkrahje të deputetit Grainca, Pal Lekaj dhe Duda Bale që kemi qenë në Komision por normalisht edhe në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Me këtë hyrje unë kisha dashur që të hapi dëgjimin publik që të gjithë të na japin rekomandimet tuaja, respektivisht vërejtjet tuaja sa i përket zbatimit të ligjit apo edhe me vetë ligjin sepse edhe aty kem mundësi që të ndërhyjmë dhe përvetësojmë. Faleminderit! Urdhëroni e keni fjalën.

Ndoshta ja kisha dhënë fjalën për hir të institucioneve zëvendësministrit dhe pastaj fjala është e juaja nga ana Faleminderit!

AVNI KASTRATI: Faleminderit, kryetar Beqaj!

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të ju përshëndes juve kryetar, por edhe grupin e deputetëve, përfaqësuesit e shoqërisë civile, drejtorin e Doganës.

Unë jam Avni Kastrati, siç tha kryetari, zëvendësministër në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Ne me të vërtetë kemi kënaqësi të veçantë sot që jemi së bashku për me mundë me gjet zgjedhje, me gjet variacione më të përshtatshme të cilat kemi me i përcjell bashkërisht në Kuvend në mënyrë që ligjet tona të jenë ligje atraktive për të gjithë ata që dëshirojnë me investua në Kosovë.

Jemi shumë të vetëdijshëm se si ministri e bartin një përgjegjësi bukur të madhe, mirëpo nuk jemi e vetmja ministri e cila duhet të punon por jemi njëra prej tyre ku për zhvillim ekonomik edhe punësim pa tjetër është e Ministria e Zhvillimit Ekonomik por njëkohësisht edhe Ministria e Drejtësisë edhe shumë të tjerë për arsye se me të vërtetë është një temë shumë e rëndësishme por njëkohësisht edhe ka implikacione prej një në ministrinë tjetër. Ne sot jemi të gatshëm që para juve të japim informacione që ne i kemi, informacione të cilat juve ju interesojnë edhe si përfaqësim nga ana e ministrisë e kemi zotin Rexhep Bllaca Drejtorin e Zyrës Ligjore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë i cili për çështjen të ligjit do të na informon, cilat janë pengesat, çka mendohet eventualisht mu bë më mirë, por njëkohësisht këtu është në ekipin tonë edhe udhëheqësi i Agjencionit për promovimin e investimeve zoti Agon Dula, i cili ka përcjell një raport të punës lidhur me disa informacione por sigurisht ka me pas edhe pyetje të tjera.

Ne me kënaqësinë më të madhe do të përgjigjemi në të gjitha ato pyetje që juve ju interesojnë por sigurisht unë mendoj që duhet me e kuptua se ky është një proces, duhet me kuptua se detyra dhe angazhimi duhet të jetë i neve të gjithëve për me mundë me të vërtetë me gjet një zgjedhje më të mirë për zhvillim ekonomik sa më të shpejtë për punësim. Dua të ju them vetëm një informacion të cilin ne e kemi vërtetua në ndërkohë nga Kosova deri tash nuk është e vërtetë që ka shkua ndonjë biznes në Maqedoni për arsye se siç thuhet nëpër media edhe shumë organizata joqeveritare Maqedonia ofron kushte më të favorshme. Ne kemi bërë analizë, kemi kontaktua me zyrtarë edhe tash për tash nuk ka biznese që kanë shkua në Maqedoni nga Kosova. Është fatmirësisht vetëm Kompania ELKOS e cila donë me u zgjerua në Maqedoni për arsye se ju e dini se në Kosovë ajo është një prej kompanive më serioze edhe shumë kisha pasur dëshirë nëse eventualisht ka dikush ndonjë informacion tjetër neve të na japë për arsye se kohën e fundit është fol shumë se bizneset edhe investimet kanë ikur prej Kosove kanë shkua në Maqedoni.

Tu ju përshëndes edhe një herë, tu ju dëshirua punë të mbarë të gjithëve po ja kaloj fjalën zotit Rexhep i cili do të na njoftoj lidhur me anën ligjore rreth Ligjit për investimet. Urdhëro Rexhep!

REXHEP BLLACA:

I nderuari deputet zoti Beqaj,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të bizneseve,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të paraqes para juve ekspozenë për zbatimin e Ligjit për investime të huaja.

Në teorinë juridike ligji ... sa për të miratuar por miratohet për të zbatuar për ta prodhuar efektin juridike të drejta dhe detyrime në praktikë, prandaj caktimin dhe vendimin e Komisionit Parlamentar për Zhvillim ekonomik për ta mbikëqyrë zbatimin e ligjit për investime të huaja në mënyrë që ligjet tona të mos ngecin vetëm si ligje në letër por të zbatohen dhe të prodhojnë efekte juridike në praktikë. Ligji për investime të huaja siç dihet ka hy në fuqi në janar të vitit 2014 dhe sa i përket shqetësimit se a ka ky ligj kolizion apo pengesa në zbatimin e tij ne si

Ministri e Tregtisë dhe Industrisë gjatë zbatimit të këtij ligji nuk kemi hasur në ndonjë kolizion apo pengesë në zbatimin e këtij ligji.

Neni 19 i ligjit parasheh relacionet, marrëdhëniet mes këtij ligjit, Ligjit për investime të huaja si dhe marrëveshjet ndërkombëtare për investime si dhe ligjeve të tjera. Neni 19 parasheh që marrëveshjet ndërkombëtare për investime të huaja kanë përparësi në krahasim me ligjet tona gjegjësisht Ligjin për investime të huaja. Ky po ashtu është në parim kushtetues ku marrëveshjet ndërkombëtare kanë përparësi në krahasim me ligjet vendore dhe ne gjer më tani kemi një numër të caktuar të marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtje të investimeve të huaja dhe jemi të proces të negocimit të këtyre marrëveshjeve me disa shtete. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është që të ofroj siguri ligjore shtesë investimeve të huaja që investimet e tyre do të mbrohen dhe do të trajtohen në pajtim me parimet e pranura ndërkombëtare si dhe një herrit shprehë gatishmëri dhe vullnetin e Qeverisë së republikës së Kosovës për t'i mbrojtur dhe trajtuar investimet e huaja.

Megjithëse Ligji për investime të huaja është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane megjithatë ne duke pasur parasysh edhe praktikën rajonale si dhe pengesat në praktikë ne si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë i kemi dy propozime për ndryshimin e këtij ligji.

Propozimi i parë është që të fuqizohet Agjencia për përkrahjen e ndërmarrjeve dhe promovimin e investimeve në mënyrë që t'i ipet autorizimi ligjor që të ketë të drejtë agjencia që në emër dhe me llogari të investorëve t'i kryejë të gjitha procedurat burokratike si dhe nxjerrjen e lejeve dhe licencave në mënyrë që të ju krijohet një ambient sa më i lehtë dhe i favorshëm për investime të huaja. Siç e përmendi deputeti zoti Beqaj, një ndër ankesat më të madha dhe sfidat më të mëdha që i kanë cekur edhe investorët e huaj është burokracia e madhe si dhe një numër i madh i lejeve i licencave të cilat vonojnë cedimin e investimit të huaj.

Si dhe rekomandimi i dytë është që të autorizohet Qeveria e Republikës së Kosovës që me vendim të Qeverisë në rast të investimeve strategjike, investimeve me vlera të mëdha si dhe investime të cilat punësojnë numër të madh të punëtorëve që të ketë të drejtë t'ia japë tokën në shfrytëzim investorit të huaj si dhe t'i ofroj lehtësira të huaja.

Ne tash e kemi në fuqi Ligjin për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme. Megjithëse ky ligj është një ligj shumë i mirë dhe mundohet t'i evitoj të gjitha pengesat dhe keqpërdorimet praktike. Mirëpo megjithatë ky ligj e parasheh gjithmonë konkursin dhe ankandin dhe kjo shihet si pengesë për .. investimeve dhe dhe i vonon fillimin e investimeve të huaja. Prandaj, rekomandimi jonë është që Qeveria e Republikës së Kosovës pas një arsytimi të detalizuar dhe të argumentuar të ketë të drejtën që investorit të huaj t'ia japë tokën në shfrytëzim si dhe t'i krijoj .. lehtësira të tjera fiskale.

Unë vetëm edhe një deshta me cek se qysh e tha edhe deputeti Beqaj ky ligj nuk mund të shihet i izoluar në familje tjera dhe se investimet e huaja janë një ... shumë kompleks dhe dimenzional dhe se zbatimi i këtij ligji involvon edhe zbatimin e ligjeve të tjera si dhe veprimin e institucioneve tjera. Pastaj politikat fiskale, forcimi i sundimit të ligjit, gjyqësori dhe zbatimi i kontratave janë kushtet themelore nga të cilat varet zbatimi i ligjit.

Unë po përfundoj këtu duke qenë gjithmonë të hapur bashkë me kolegët që të përgjigjem pyetjeve dhe shqetësimeve të juaja. Faleminderit!

KRYESUESI:

Faleminderit, zoti Bllaca!

Fjalën e ka kërkuar përfaqësuesi i Odës Ekonomike të Kosovës, zonja Lumnije.

LUMNIJE HASHANI:

Faleminderit, kryetari Beqaj!

Përshëndetje për të gjithë,

Unë jam Lumnije Hashani, nga Oda Ekonomike e Kosovës.

Ne e përshëndesim iniciativën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik duke konsideruar si hap shumë të rëndësishëm i cili ka reflektuar pozitivisht te komuniteti i bizneseve.

Të nderuar deputetë,

Nga Komuniteti i biznesit nuk kemi marrë shumë propozime që kanë të bëjnë kryesisht me Ligjin për investime të huaja por kemi kërkesa të cilat ndikojnë tërthorazi apo indirekt në tërheqjen e investimeve të huaja.

Si kërkesë e parë është që të ndryshohet emri i Ligjit për investime të huaja të zëvendësohet me Ligji për investime me qëllim që të bëhet një ligj unik i cili do të merret me investime të huaja dhe ato vendore dhe do të ndikoj në tejkalimin e burokracisë dhe dualizmit. Si kërkesa të tjera të bizneseve të cilat janë paraqitur por që nuk ndikojnë me Ligjin mbi investime të huaja janë politika të këqija fiskale, mungesa e subvencioneve, normat e larta të interesit bankar që janë më të shtrenjta në rajon, konkurrenca jo e drejtë, energjia e shtrenjtë, humbja e fuqisë në treg, monopolet, licencat, lejet e punës, mosefikasiteti i sistemit gjyqësorë dhe moszbatimi i kontratave nga organet gjyqësore të cilat bizneset kanë kërkuar që këto të ndryshohen.

Ne mendojmë se për krijimin e kushteve sa më të mira për investime të huaja nuk mjafton vetëm ky ligj por duhet rishikuar tërë legjislacioni i cili merret me krijimin e kushteve sa më të mira për të bërë biznes. Pra, së bashku me Ligjin për investime të huaja duhet të ndryshohet edhe Ligji i punës, Ligji për dhënien e lejes për shtetasit e huaj si dhe Ligji për këshillin ekonomik social.

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të eliminimit të diskrepancës e cila paraqitet mes zgjidhjeve ligjore që paraqiten në Ligjin për investime të huaja dhe praktikës së implementimit të tij ne kërkojmë që Komuniteti i Biznesit të ftohet në çdo grup punues i cili merret me hartimin e legjislacionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, shumë e nderuara zonja Hashani!

Dhe ju përfaqësues kisha dashur që gjatë leximit publik të jeni shumë konkret sa më konkret që është e mundshme. Nëse flasim për politika të këqija fiskale të cilat janë defekte të politika fiskale dhe çka ne duhet të bëjmë, çka duhet të marrim hap për ta ndryshuar politikën fiskale. Nëse themi që është konkurrenca, monopoli çka konkretisht, ne duhet këtu të dalim me rekomandime të qarta, kjo të themi që është politika fiskale themi që është konkurrenca, monopoli janë gjëra që secili shtet i diskuton si qasje për t'i përmirësua, por kisha dashur që të

jemi sa më konkret. Pra edhe një herë po ju lus që t'i thuani gjërat të cilat biznesi edhe juve edhe neve na i ka thënë nëpër takime që i kemi pasur. Urdhëroni, zoti Pacolli!

ISLAM PACOLLI:

Përsëritje kryesues!

Përsëritje deputetë të nderuar,

Ju pjesëmarrës të tjerë,

Faleminderit për fjalën!

Sigurisht që gjithmonë bizneset kanë ankesa dhe unë në këtë rast nuk dua me thënë ankesa por unë kisha pasur dëshirë që të sugjeroj dy tri pika nëse ne me të vërtetë e dom këtë vend dhe dom me të zhvillimin ekonomik, zhvillimi ekonomik nuk bëhet me fjalë po donë me vepra, vepra konkrete është e zhvillimit ekonomik është prodhimi vendor.

Për me ekzistua prodhimi vendor do të thotë duhet mu të bë politika konkrete me kushte të barabarta me kushte gjithmonë të barabarta që të jenë hapësira për prodhimin vendor sidomos në projektet vendore që ne i kemi këtu.

Kisha pasur dëshirë që të sugjeroj që dogana dhe TVSH-ja për projekte që kanë të bëjnë me prodhimqë të hiqet në tërësi për arsye që TVSH-në kanë kohë me e paguar sa të dësh gjetë funksionimit që janë punëtorë të zhvillimit pastaj e ... dhe natyrisht dua me e cekur meqë po e shoh drejtorin e Doganave këtu, me cekur edhe një çështje që garancionet për depot doganore për prodhime, të pranohen si garancione do të thotë të kompanive të sigurimit për arsye që këtu është një jo e barabartë derisa për deponit, depot doganore të tregtarëve pranohen, kurse të prodhuesve jo që unë konsideroj që kjo ishte dashur të jetë barabartë e kundërta. Kjo është një politikë jo për zhvillim e vendit, pastaj ne këto prodhime që ne, prapë po them është e vetmja mundësi zhvillimi i vendit është prodhimi vendor. Prodhimi vendor jo duke i shkelur të drejtat, jo duke pos prodhuar cilësi, por një cilësi të barabartë duhet me qenë përparësia të prodhimi vendor. Deri tani nuk ka ndodhur, kjo ka ndodhur edhe e kundërta. Ne kemi shumë prodhime tjera që nuk kanë ndodhë por sot nuk jemi për ato është vetëm sugjerim.

Unë përfaqësoj Kompaninë MABETEX GRUP në Kosovë të cilën ka shumë prodhime brenda grupit të vet, por me të vërtetë depoja doganore sikur te, tani pajisjeve të reja sene, ne i kërkojmë që të hiqet edhe TVSH-ja për arsye që unë dëgjova edhe më herët përfaqësuesin e Ministrisë për Tregti, Industri, që tha me përparësi investimet e huaja. Unë mendoj është me përparësi prodhimi vendor, investimi vendor dhe i huaj. Pse duhet me të bë diferencë?

Në rast se një vendor ka me bërë një prodhim të njëjtin sikur që e bënë një i huaj, pse mos të jepet e drejta e barabartë që ne nuk duhet me e zgjedhë se të kujt janë të hollat, por çfarë forme investuan dhe me të vërtetë ta kontribuon në të mirën e zhvillimit. Nuk kisha dashur tani të shtojmë shumë. Faleminderit shumë për fjalën.

KRYESUESI: Faleminderit zoti Pacolli! Deputeti Grainca

BLERIM GRAINCA: Përsëritje për të gjithë,

Edhe komunitetin e biznesit dhe në veçanti më të rinjtë dhe shoqërinë civile që janë këtu.

Më duhet të them se fillimisht kur e kemi menduar idenë e diskutimit publik, gjëndër problemet teknike që kemi diskutuar kanë qenë edhe hapësirat e vogla që kemi këtu edhe frika se do të kemi një prani të madhe të komunitetit të biznesit dhe të odave që veprojnë në Kosovë, por takimi i sotëm po na demanton sepse them të drejtën nuk jemi edhe aq të kënaqur me praninë e komunitetit të biznesit dhe veçanërisht me praninë e përfaqësuesve të tyre, në këtë rast asociacioneve. Odave ekonomike, me përjashtim të Odës Ekonomike të Kosovës që janë këtu, sepse gjatë takimeve që kemi pasur në terren edhe gjatë atakimeve që kemi pasur me asociacionet e biznesit, vërejtjet në këtë ligj kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha dhe kërkesat për ndryshime kanë qenë po ashtu të mëdha.

Është bërë praktikë se kur po flasim për investime në Kosovë, zakonisht po i referohemi problemeve që ka Kosova e në veçanti problemet mega që po i përmendin të gjithë siç janë: korrupsioni, shtetit ligjor, funksionimi i gjykatave, burokracia në institucione, monopolet dhe favorizimet e ndryshme, favorizimet që i bëhen bizneseve të ndryshme. Shpeshherë kemi dëgjuar edhe për privatizimin si proces të dështuar dhe jo efikas, për metodat që kanë qenë dashur të aplikohen dhe së fundi edhe për politikat fiskale. Siç u diskutuar këtu, ne jemi të gatshëm dhe për të dëgjuar më shumë propozime praktike nga ana e juaj, për shembull kur flasim te politikat fiskale, a është TVSH-ja ajo që po e pengon, a është rimbursimi i TVSH-së, a po kthehet TVSH-ja me kohë ajo që po ju merret në kufi, pastaj cilat janë politikat që duhet ndryshuar edhe te Dogana, çka duhet të bëjë Dogana më shumë për me qenë më efikase, mos me e penguar bizneset, a është marrëveshje tregtare që kemi nënshkruar, a janë pengesë për zhvillimin, e defavorizojnë prodhimet vendore, ndoshta edhe CEFTA-a është pengesë, ndoshta edhe marrëveshjet e tregtisë të lirë me Turqinë dhe vendet e tjera. Të gjitha këto janë probleme që ne do të donim t'i dëgjonim sot nga komuniteti i biznesit. Prandaj, të themi në thonjëza na shfrytëzoni sa na keni këtu sepse do jemi gjithmonë në shërbim të juaj për t'i ngritë problemet që keni ju dhe për ta bërë ligj më funksional.

Kosova deri më tani nuk e ka pasur problem ekzistencën e madhe të ligjeve, e ka pasur problem funksionimin e tyre praktik. Ta bëjmë këtë ligj më praktik edhe më të favorshëm edhe për bizneset e huaja që vijnë në Kosovë, e sidomos për bizneset vendore sepse mendoj se duhet të kemi një trajtim të barabartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Zoti Allajbeu

KLODIAN ALLAJBEU:

Mirë dita!

Jam përfaqësues i Spitalit Amerikan të Tiranës.

Spitali Amerikan, ka filluar aktivitetin në 2005 në Shqipëri si investim i fondit Amerikan të Zhvillimit në Shqipëri është investuar rreth 55 milionë euro për një kohë 8 vjeçare dhe jemi lider në treg me 1000 të punësuar dhe rreth 300 shtretër. Kemi 3 vjet që filluam aktivitetin edhe në Prishtinë me një investim të vogël dhe tashmë jemi në fazën e hapjes të një spitali të përgjithshëm, të plotë që kap investimin e një shifre rreth 16 milionë euro, përfshirë objektet e pajisjet së bashku. Është një histori që vjen nga rreth 6 vite më parë kur është dhënë leja e ndërtimit në një pronë që është dhënë në shfrytëzim nga komuna e Prishtinës. Po ashtu është marrë edhe një vendim qeverie i posaçëm që lejon ndërtimin e këtij spitali aty duke e parë si një partneritet publiko-privat dhe si një investim të rëndësishëm për shëndetësinë në Kosovë.

Dihet situata e shëndetësisë në Kosovë, dihet migrimi i pacientëve kosovar në Shqipëri, Turqi dhe në gjithë vendet e mundshme të botës për t'u trajtuar dhe ky investim, është një investim që normalisht duhet të jetë i mirëpritur, duke pasur parasysh dhe nga vjen, problemi i paqëndrueshmërisë në marrjen e vendimeve, të vendimeve që janë marrë nga qeveritë e mëparshme dhe hezitimi i Qeverisë aktuale për vazhdimësinë e këtij projekti me pajisje me lejen e funksionimit të spitalit, ka ngjallë një hezitim shumë të fortë tek investitorët dhe dihet që janë investitorë që janë prezentë në Kosovë, me një investim tjetër po ashtu serioz që kanë edhe kujtesën si investim, është një fond amerikan që ka në rajon rreth 350 milionë dollar investime duke filluar në është SIF ... Fodi i Evropës Juglindore ku 60% të aksioneve të fondit i zotëron OPIKUQ, janë fonde shtetërore të shtetit amerikan dhe vështirësitë që hasin për ne janë të papranueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Allajbeu!

Sigurisht që ne si Komision do t'i transmetojmë edhe shqetësimet tuaja lidhur me procedurën, por njëkohësisht edhe shqetësimet të cilat u ngritën edhe nga Oda Ekonomike dhe nga zoti Pacolli.

Ne këtu sot jemi për të bërë debat lidhur me funksionimin dhe mundësinë e intervenimit shtetëror që investitorët qofshin të huaj apo vendor, të trajtohen sa më mirë që është e mundshme. Pra kjo është logjika për të cilën neve jemi duke punuar dhe besoj që, nëse flasim hapur, se flasim pa hezitim lidhur me problemet, sigurisht që atëherë ato mund të trajtohen.

Ju kisha lutur sikurse u tha edhe nga zoti Pacolli edhe nga zoti Beu që të jeni sa më konkret, të dimë për gjërat të cilat janë aktualisht probleme. Ne kemi marrë edhe nga takimet që kishim me Odën Ekonomike, Odën Amerikane edhe rekomandimin që ai vendimi për pushimet nga taksat, duhet të vëhet në jetë sa më shpejt që shkon krah për krahë me propozimin e zotit Pacolli lidhur me investimet e reja, pushimet nga taksat, heqjen e TVSH-së, nga kufiri për investimet në pajisje dhe në mjete të punës të cilat në mënyrë automatike e mundësojnë një lehtësim jashtëzakonisht të madh. Pra është një vendim i cili është më herët i Qeverisë dhe i cili duhet të vëhet në jetë sa më shpejtë dhe ky do të jetë një nga rekomandimet të cilat ne si deputetë do t'ia dërgojmë edhe Qeverisë por do t'ia dërgojmë edhe seancës së Kuvendit.

Urdhëroni, unë në listë po shohë që keni përfaqësues të firmave të ndryshme këtu, prandaj kisha dashur që të gjithë ato arsyet e juaja për investime apo për mos investime apo shqetësime apo burokraci apo çfarëdo dukuri që është, të na thuani hapur sot dhe ne pastaj t'i procedojmë. Urdhëro zotëri, edhe tash për hir të procesverbalit prezantohuni dhe kënd e përfaqësoni.

AZEM LIKA:

Përfaqësoj firmën "Shendi" Kaçanik.

Unë së pari ju falënderoj për këtë iniciativë jashtëzakonisht të mirë. Neve si Kosovë, neve na nevojiten investimet e huaja që të hyjnë në Kosovë, mirëpo duke ditur se për të hyrë në Kosovë duhet të kemi kogja telashe, së pari ju që thatë duhet konkretisht të bisedoni edhe të konkretizoni. Unë po jua citoj një ligj në të cilin është shkallëzimi i TVSH-së. Aty kam parë si kogja aty ku janë të shkallëzuar me TVSH, ku thuhet decidivisht, thotë "vetëm uji ia ambalazhuar nuk shkallëzohet me TVSH me 8% me 18% , do të thotë së pari na duhet me e

ditur se a jemi për me e mbrojtur interesin e gjithë popullatës së Kosovës, nëse nuk kemi ujë të pastër kujdesi 75% i organizmit është prej ujit, e na kërkojmë si tha zotëriu për Spitalin Amerikan, atëherë e gjithë popullata do të shkon nëpër spitale. Na po i kursejmë 8% për shkallëzimin e TVSH-së, kurse po i qojmë popullatën të gjithë për çështjen e shëndetësisë, të veshkëve po e di se çfarë problemi na kemi me veshkë, me ushtrinë dhe të gjitha gjërat, kurse pjesa tjetër çka vështirësi biznesi, është rryma sezonale verore, dimërore. Ne këtu faktikisht të huajt nuk besoj se do të vijnë t'i bëjnë dy lloj çmimesh, çmimet në sezonën dimërore t'i ngrisin kurse sezonën verore t'i zbresim. Këtë po e them për arsye se në sezonin dimëror rryma ngritet për 150% kurse në sezonën verore prej 1 prill zbret. Na faktikisht duhet me i kursye të gjitha mundësitë për me e mbajtur një çmim sezonin veror dhe sezonin dimëror çka nuk ka mundësi.

Pika tjetër është: taksat ujore kanë vendosur në një paketim, taksë ujore kërkojnë 10.9 cent kurse TVSH-ja plus 54 cent flasin për lëngjet prodhimet vendore, kurse akciza 54 cent çka do të thotë me çmim 2 euro e 60 cent për një arkë lëngë prodhim vendor të Kosovës, paguajmë 1 euro e 06 cent shtetit pa i shti kontributet e punëtorëve, tatimi në fitim e këto. Pra, na kemi goxha probleme të brendshme për me e josh një investitor të huaj, atëherë goxha duhet me i shoshitë këto probleme këtu çka na nevojiten. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Pacolli edhe një herë!

ISLAM PACOLLI: Faleminderit kryesues!

Sigurisht ne jemi këtu për debat dhe jo me heshtë, se ne kur dalim nga takimi kemi shumë arsye asnjë nuk e ka guximin me fol.

Janë dy çështje, unë e ceka edhe më herët rreth çështjes të investimeve për prodhime por aty është e mirë me qenë komplet projekti jo vetëm teknologjia. Sa më shpejtë me vu në jetë teknologjinë, sigurisht që do të na shërbejë shumë për nxitjen e investimeve.

Te rryma e përmende edhe më herët. Ky është një problem tepër shqetësues përpos që ndryshohen tarifat dhe është edhe një tjetër që këtë e kam parë vetëm në Kosovë, në asnjë vend tjetër që sa më shumë të shpenzosh, kostoja rritet më shumë. Nuk kam parë kur, mendoj se ai që shpenzon shumë, duhet me pasur përkundrazi lehtësim më shumë për arsye se është një shpenzues i madh, e te ne është e kundërta, është mirë ndoshta deputetët dhe ju mundeni me e qua këtë çështje përpara, me e marrë ndonjë veprim. Faleminderit!

KRYESUESI: E kemi deputetin Lekaj!

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendësministër,

Përfaqësues të bizneseve,

Deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Ne jemi takuar sot bashkërisht që të bisedojmë për plotësim ndryshimin e Ligjit për investime të huaja. Ajo që e tha edhe kryetari, ne i kemi hyrë kësaj pune për t'i lehtësuar bizneset dhe Ligji që të shkoj në favor të zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe favorizojë investitorët, qofshin vendor apo të jashtëm dhe për asnjë arsye tjetër. Mirëpo nga kontaktet që kemi pasur edhe në Oda edhe në Ministrinë për Tregti dhe Industri, nuk e kanë fortë të qartë, janë thënë: ne jemi

kon të shqetësuar për ramjen e investitorëve të huaj në vend. Nëse e krahasojmë me vitet paraprake dhe ne kemi menduar që a thua mos është Ligji problem apo Kosova është e disfavorshme për investime të huaja dhe nga ajo që kemi marrë, do të thotë nuk kemi shumë vërejtje në Ligjin ekzistues apo me atë që quhet favorizim i investimeve të huaja, qofshin ato të huaja sepse vetë jemi dakorduar që mos të quhet më Ligji për investitorë të huaj sepse duhet të jemi të barabartë, ka edhe investitorë të brendshëm që shumë në Kosovë kanë investuar, dhe jemi të padrejtë nëse ne i favorizojmë dhe e quajmë Ligjin për investime të huaja. Aty pajtohemi të gjithë dhe besoj që kjo do të ndodhë.

Por, ajo që mendoj se është dashur që të ndodhë është thënë neni kaq, kaq mendoj se është i disfavorshëm për investimet dhe duhet të plotësohet me këtë, këtë, këtë. Deri sot nuk e kemi bërë. Kërkoj falje, por desha ta dijë, e përmendët të fuqizohet agjencioni për promovime të huaja. Çka mendoni, në resurse humane të ipet kompetenca më tepër dhe si... çka është? Përmendet prapë Oda Ekonomike, politikat fiskale dhe pajtohemi që të kenë zbritje dhe të jenë, të krijojmë një klimë për të investuar. E përmendi Spitalin Amerikan, po e them që çka është licenca e shkurtë licenca, atëherë le të thuhet që ne kërkojmë licenca të jetë në vit kaq, 5 vite ose 10 vite ose 2 vite, meqë ndoshta e keni ndoshta vetëm për një vit dhe është e pakuptimtë kjo që në një investim që kalon miliona që t'i jepet licenca për një vit. Duhet të shtojmë trupat monitorues e jo t'i sanksionojmë me afat të shkurtër, për shembull kur jeni me një licencë njëvjeçare.

Përmend dhënien, Qeveria të vendos për pronën në një afat më të gjatë, apo të ketë të drejtën Qeveria për pronë që t'i jepet një investitori që ka lënë miliona, por nuk po e di për sa vite mendoni, si mendoi sepse atëherë nuk jemi të barabartë dhe shumë këto çështje mendoj që ne jemi këtu që të jemi, të favorizojmë juve, jo për vete dhe njerëzit takohen për të ndryshuar pozitivisht. Prandaj, ne jemi të gatshëm si deputetë që zërin e juaj të bëjmë në plotësim-ndryshim të Ligjit që shkon në favorin tuaj, qofshin investimet që vijnë nga jashtë, por edhe me shumë nga brenda. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Lekaj!

Kisha dashur që këtu kemi edhe nga Shoqëria Civile që merren me zhvillimin ekonomik, por edhe... të është dëgjim publik. Të gjithë jeni të mirëseardhur që të jepni komentet tuaja apo të përçoni ndonjë problem të cilin ju e keni observuar gjatë një periudhe kohore. Urdhëroni zotëri!

AVNI KURSHUMLIU:

Vijë nga firma Gjermane "BIFINGER" e cila merret me realizimin projekteve në zhvillimin e energjetikës, kryesisht prej thëngjillit.

Qe tri vitet e fundit, praktikisht jemi mundur rreth realizimit të një projekti të madh energjetik këtu në Kosovë, deri tani mundem me thënë pak suksese. Gjatë kësaj kohe kemi vërejtur që edhe Ligji për investime të huaja edhe në kuadër të tij edhe Ligji për partneritet publiko-privat, ka mangësi të mëdha, nuk po thonë që shumica e udhëheqësve ndoshta e ish Qeverisë të atëhershme, është pak i njohur. E Ligji për PTT si i thoni, është i paqartë, ai përmban ende direktivat e kryeministrit, nuk jep shpjegime të mjaftueshme.... kur një investitor mund të shkojë në këtë bazë të partneritetit publiko – privat pa tenderim. Domethënë krejt janë këto pengesa, unë

them për vete që dy investitor amerikan, njëri pas tjetrit na kanë pritur nga një vit dhe kanë shkuar, se thjesht nuk kanë marrë përgjigje.

Disa zotëri e përmendën këtu energjetikën, por nuk e përmendën që mungon energjia, por që është më e shtrenjta. Ajo ka me qenë edhe më e shtrenjtë, për shkak se ky turku s'ka ardhur këtu për ta falur energjinë, por dëshiron fitimin, gjithnjë më pak e më pas, për shkak se kemi hyrë në një krizë energjetike, e cila do të shkaktojë jo shkallëzimin verë e dimër, por edhe shtesa tjera.

Prandaj, konsideroj që si bazë për të shkuar, për tu realizuar Ligji për investime duet pasur strategji shtetërore, strategjia e zhvillimit, se në rast se lejohen që vetëm pompa te benzinës të na hap dikush, atëherë kemi me pas pompa te benzinës sa të duash, sikurse i kemi.

Prandaj, strategjia sa më parë duhet të aprovohet. Kur e them këtë më së pari baza është strategjia për energjetikën. Pa pasur strategjinë për energjetikën, ne kemi mbetur në një Kosovë të re, të cilën jemi duke e ndërtuar që 15 vjet. Kaq ishte, faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë, zoti Kurshumliu!

Sigurisht që çështja e energjetikës është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme dhe me shumë dimensionë të natyrave të ndryshme. Edhe njëherë po ju them, ju kisha lutur që kur të flasim të japim gjëra konkrete, se cili është problemi tek ju.

Unë jam personalisht i njoftuar me atë projekt, por ju e dini që ai projekt ka edhe probleme me rregullat dhe direktivat e Bashkimit Evropian për energjinë, por ju kisha lutur, që ato procedura të cilat ju konsideroni që nuk janë në rregull, atëherë të na i thoni këtu hapur. Urdhëroni! Kolegë.

DARDAN ABAZI:

Nga Instituti për politika Zhvillimore INDEP.

Dua të filloj duke thënë që edhe INDEP-i mendon që Ligji për investime të huaja duhet të quhet, në fakt, Ligji për investime dhe investitorët vendor të trajtohen në mënyrë të barabartë me investitorët e huaj.

Dua të shtoj vetëm një element tjetër nga ajo çka u tha këtu, e ajo më erdhi si një citim nga një raport i Bankës Botërore, që quhet "Investors Perception of Kosovo's Business Environment" dhe, menjëherë mbas sundimit të Ligjit të korrupsionit, një problem të cilin investitorët e kanë identifikuar, ka qenë edhe mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Mendoj që një ligj për investime të huaja gjithashtu, duhet të përfshijë patjetër atë trekëndëshin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe bizneseve. Kjo do të arrihej duke pasur një kurrikul mësimore aktive dhe të ndryshueshme vazhdimisht, e cila do tu përgjigjej kërkesave të investitorëve.

Normalisht, ligji duhet të përfshijë edhe luftimin e krimit të korrupsionit. Sot kemi pasur një shkrim në gazetë lidhur me një problem të një investitori të huaj me marrje të pronës e të ngjashme. Investitorët e huaj shkojnë në Maqedoni, për shkak se në Maqedoni, tash po flasim

nga këto biseda që ne i kemi pasur, në Maqedoni ata po thonë që ne po japim veç në një vend korrupsion, e jo në shumë raste. Këtu po duhet me u zgjerua. Kaq kisha. Domethënë, kurrikula mësimore t'i përshtatet kërkesës së investitorëve.

KRYESUESI: ... urdhëroni nga Agjencioni për ndërmarrjeve.

ADNAN DULA: Faleminderit, zotëri deputet!

Unë jam Adnan Dula, drejtor i Drejtoratit për promovim të sektorit privat në kuadër të Agjencisë për Investime dhe me përkrahje të ndërmarrjeve në Kosovë KIESA.

Me sa u tha këtu, unë e përkrah plotësisht profesorin Beqaj, që duhet me pas kritika sa më konkrete, se neve na interesojnë ato për të marrë, unë u mundova të mbaj shënime për çdo problem që kanë komuniteti i biznesit, por ne kemi dërguar, kjo është hera e tretë që jemi takuar me komisionin dhe jemi munduar t'i identifikojmë vazhdimisht të gjitha problemet. Kurse, problemet ose propozimet që vijnë nga ligji ose problemet që kanë pasur investitorët e huaj, ose investitorët vendorë që me të drejtë është propozuar që të ndryshohet emri i ligjit e të bëhet Ligji për investime, ne i kemi përmbledhur me 2 – 3 herë një set pyetjesh, që jemi përgjigjur me atë që kemi mundësi dhe me ato informata që i kemi pasur në agjencinë tonë, ku i kemi mbledhur informatat me ankesa të ndryshme, që kanë ardhur nga komuniteti i biznesit dhe investitorët e huaj.

Ne i kemi përfshirë edhe një numër të rekomandimeve, që përfshijnë edhe politikën fiskale, nevojën për ndryshim të politikës fiskale, nevojën për ndihmesë në edukimin, ose trajnimin e fuqisë punëtore në kuadër të komunitetit të biznesit në Kosovë, nevojën për fuqizim sa më të shpejtë ose implementim sa më të shpejt të skemës së garantimit të kredive e tjera, e tjera. Këtë ia kemi dërguar si raport komisionit.

Gjithashtu, unë mendoj që ka qenë kohëve të fundit një fushatë shumë e fuqishme prej anës së shtetit të Maqedonisë, për ta dëmtuar imazhin e Republikës së Kosovës, sa i përket tërheqjes së investimeve të huaja. Unë i kam marrë disa shënime këtu, ku shihet trendi i investimeve të huaja edhe në Maqedoni, edhe në Serbi, edhe në shtete të rajonit. Në bazë të dy kuartalëve ose tremujorëve të parë të vitit 2014, se ne e kemi deri në tremujorin e tretë të vitit 2014, shënimet që i kemi nxjerrë nga Banka Qendrore e Kosovës, se ende nuk janë publikuar për gjithë vitin komplet. Maqedonia i ka diku 140 milionë për dy tremujorët e parë të vitit 2014 investime të huaja. Që trendi i rënies edhe në Maqedoni është shumë i madh. Në qoftë se, ata paskan një politikë aq të mirë dhe kushte shumë atraktive për investitorë të huaj, nuk e di pse nuk ka shkuar, nuk ka pasur një trend të kundërt, rritje të investimeve të huaja, por ka qenë... ne me trendin që kemi po mundohemi që ta mbyllim vitin 2014, kur t'i marrim shënimet nga Banka Qendrore e Kosovës me një trend të njëjtë me vitin 2013, ku ka qenë diku rreth 280 milionë investime të huaja.

E di që ka shume probleme, e di që nuk është një shifër e kënaqshme, por as edhe ne Serbi kemi shifrat i kam nxjerrë për trendin e prej vitit 2007 trendin e investimeve ku ka pas rënie të investimeve, kohë pas kohe, për shkak të trendit global të rënies së investimeve në shumë vende të botës. Edhe për shkak të krizës financiare në Bashkimin Evropian e tjerë, e tjerë...

Unë kisha pasur dëshirë shumë që të dëgjojmë raste konkrete për çdo lloj të investimit. Ne kemi qenë të hapur çdo moment edhe për çdo investitor të huaj që jemi taku, ju kemi jap mundësinë që me na kontaktua edhe jashtë orarit të punës, edhe në çdo moment, për me qenë në gatishmëri me ju ndihmua për çdo nevojë që kanë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Dula! Unë desha vetëm ta bëjmë një degridion, se ne në tri takimet që kemi pasur me Ministrinë e Tregtisë e Industrisë, kemi kërkuar edhe të na vihet me një analizë lidhur me atë se çka është duke ndodhur me këtë trendin e ikjes, nëse mund t'i quajmë ikjen e investimeve të huaja. Kemi kërkuar që kur flasim për rënien e investimeve të huaja, kemi kërkuar që të na bëhet një krahasim me vendet e rajonit për të hyrat apo investimet, të cilat bëhen për kokë banori, sepse kjo do të ishte masa më e mirë e mundshme, me thënë që Kosova ka rënie të madhe të investimeve të huaja dhe vendet e Rajonit kanë më pak rënie të investimeve të huaja. Nuk mund të themi që kemi kaq investime të huaja në Kosovë dhe kaq investime të huaja në një shtet tjetër, sepse funksionaliteti i tyre mund të jetë krejt ndryshe dhe numri i popullsisë mund të jetë ndryshe.

Pra, për ta pasur një pasqyrë të mirëfilltë të investimeve të huaja, ne kemi kërkuar nga agjencia, që të mos rrinë duarkryq dhe të thuan që po bën fushatë Maqedonia dhe tash ne po rrimë. Pra, në parim kemi kërkuar, që nëse s'ka raste të tilla dhe nëse ka, të bëhen krahasime, cilat janë politikat e mira në shtetet tjera, nuk po themi vetëm në Maqedoni, të cilat po na i tërheqin investimet. Cilat janë konkretisht politikat fiskale, që ata i kanë më të mira se ne? Të bëjmë krahasim, pastaj mund të vijmë te një konkludim. Të mos jemi kështu pak, unë desha pak me ia dhënë edhe njëherë, edhe një fuqizim diskutimit, që të koncentrohemi në gjëra të cilat janë konkrete.

E kemi deputetin, pastaj zoti Pacolli edhe njëherë dhe edhe njëherë zoti Hoti.

ENVER HOTI:

Faleminderit kryetar Beqaj!

Në mënyrë të veçantë përshëndes grupin punues për punën që e ka bërë për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve për investime të huaja. Ndajmë mendimin, disa nga çështjet i tha edhe kryetari, që pata ndërmend me i cekë. Më shumë u motivova nga përfaqësuesit tanë të Qeverisë, që janë këtu, që të marr pak fjalën.

Siç e tha edhe në fillim të fjalës së tij, zoti Grainca, që është pak shqetësuese edhe mungesa e interesimit për dëgjim publik. Kjo më shumë shfaqë, ndoshta, edhe besimin që e kanë njerëzit, afaristët e ndryshëm, institucionet e ndryshme, konkretisht institucionet në Qeverinë e Kosovës.

Këtu unë e shoh dhe në këtë kënd dua ta shoh, sepse mospjesëmarrja në dëgjimin publik, që ka të bëjë me sektorin e zhvillimit në ekonominë e vendit, nuk është shenjë e mirë, është një sinjal jashtëzakonisht negativ. Këtu pra, kemi të bëjmë me humbjen e besimit të afaristëve në institucionet e vendit, sipas mendimit tim.

Absolutisht, e ndajmë një mendim, që e tha zoti Beqaj, që nuk duhet ndoshta të përqendrohemi në propagandë, si “po bën Maqedonia” ose shtetet fqinje propagandë. Cilat janë masat, që ne duhet të ndërmarrim, zotërinj të nderuar, për promovimin e investimeve, ju që po i merrni ato

masa për të bërë funksional. Unë po mendoj, që nuk jemi duke vuajtur nga ligji që është funksional, tani i shkruar, dua të them, por po vuajmë nga zbatimi i ligjit. Nuk është krejt perceptcion ndoshta në atë se ka monopol, ka korrupsion, ose siç e tha kolegu atje, është një adresë, siç e tha ai, ka një adresë në Maqedoni, ku mund të bisedohet ndoshta edhe për korrupsion.

Edhe ne ndoshta, aq shumë, s'marr të drejtën të them, por perceptcioni është i tillë, që janë bërë shumë adresa dhe, jo vetëm investitorët e huaj, por edhe këta të brendshmit kanë rënë në telashe dhe nuk po kanë mundësi kurrqysh me gjet së paku mundësinë të komunikojnë me dikë. S'ka nevojë të thirren investitorët e të bisedohet jashtë orarit të punës. Neve na del mjaft orari i punës prej tetëve deri në katër. Absolutisht na mjafton, është i mjaftueshëm. Të bisedojnë zyrtarët tanë, qeveritarët tanë, vetëm brenda asaj që thirren në orar të punës. Thirrja jashtë orarit të punës, jep mesazh të keq. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë!

ISLAM PACOLLI: Faleminderit shumë, kryesues! Shpresoj që s'e kam tejkaluar kështu...

Nuk desha më herët që të kyçem kështu, drejtpërsëdrejti në projekte, duke marrë parasysh që të mos merret personale, por unë mendoj që gjatë hartimit të projekteve qeveritare, do të thotë aty bëhet një lojë jokorrekte ndaj prodhimeve vendore. Hartimi i projekteve duhet të jetë në atë formë që duhet të ceket, që në rast se është i njëjti prodhimi vendor, të ketë përparësi prodhimi vendor. Do të thotë, këtu është një defekt.

Po e marrim shembull, po e bëjmë një prodhim vendor këtu, por në rast se ky prodhim vendor nuk mund të futet këtu në treg, çfarë arsye ka me pas ky prodhim vendor, apo çka e shtyn një investitor që të vijë të investojë në Kosovë?

Pra, marr dy shembuj, edhe pse prapë po e cek, nuk desha t'i marr më herët. Është Fabrika e Gypave në Ferizaj, e cila ka prodhuar gypa, e dëshmojmë me kontrata e me krejt, për ujësjellësin në Beograd, prodhon gypa për eksport në Greqi, në Shqipëri ma është jashtëzakonisht dominuese, për trase të ngrohjeve e të gjitha këtyre, për ujësjellës e të gjitha. Nuk ka asnjë mundësi të jenë prezentë në Kosovë. A nuk ju duket, që kjo është shqetësuese. Unë mendoj që kjo është shumë shqetësuese. Dhe, çfarëdo prodhimi që të vijë këtu, në rast se nuk ka përkrahje gjatë hartimit të projektit, kuptoni, është e pamundur që ajo të funksionojë. Edhe në rast se ju do ta hiqni TVSH-në, Doganën e të gjitha ato, prapë kjo nuk do të mjaftojë në rast se, në hartim bëhen lojëra dhe ceket aty se kjo, kjo... dhe i gjendet një pikë ku duhet me qenë...

Ju merreni me mend, vetëm tenderi i Termokosit ka qenë që duhet pasur tri vjet menaxhim të ngrohjes për një qytet. Do të thotë, është... veç që s'ja kanë shkruar emrin se kush ka me e marr atë projekt. Domethënë, atëherë pse ne po e bëjmë atë? Çfarë përkrahje është zhvillimi i vendit tonë? Nuk është kjo përkrahje, ju lutem! Derisa, ju e dini fort mirë, që Beogradi dihet që ne kemi qenë deri sot dhe, prapë nuk jemi në rregull, do të thotë, nuk kemi kurrfarë miqësie, apo fqinjësie të mirë, por e din që është një prodhim cilësor dhe e merr atje, kurse këtu në Prishtinë është e pamundur kjo të ndodhë, Termokosi po ashtu. Dhe kjo në një formë a tjetër, e shuan prodhimin dhe zhvillimin ekonomik. E shuan, drejtpërsëdrejti!

Ju e cekët korrupsionin. Korrupsionit pak nëse njerëzit nuk ia ndihmojnë, nuk mund të ndodhë. Do të thotë, biznesi duhet me qenë këmbëngulës në këtë drejtim. Unë e di që pëson në start, por me kohën vjen te vendi. Unë ju them shumë drejt, ne i kemi dy prodhime që janë për t'i përmendur M-Teknologji, 70 – 90% shkon jashtë vendit prodhimi, për arsye që këtu është pak vështirë, se kur të vjen koha, si pallati i drejtësisë, si shumë gjëra, vijnë prej vendeve të tjera, se ne ia ndihmojmë. Njerëzit që bëjnë hartimin e projekteve e përkrahin që të shkojë jashtë vendit.

Do të thotë, nuk është tani vet te ministri, s'ka çka të bëjë ministri, nëse hartimi gjithçka thotë ndryshe, ministri është veç figurë, aty është pa emër, që do të përfillet për çdo ditë, por në fakt rrobat ia presin hartuesit e projekteve. M-Teknologji do të thotë që prodhon 70 – 90% për jashtë vendit prodhimin e ka dhe shpeshherë punon me dy ndërrime, për arsye se ka prodhim jashtëzakonisht dhe të kërkuar. Por, nuk ka mundësi fort të futet në treg në Kosovë.

E dyta, Fabrika e Tubave punon çdo ditë, ka numër të madh të punëtorëve, por fatkeqësisht, jo për Kosovën. Fatkeqësisht! Gjithë Ujësjellësi, gjithë ngrohja, gjithë është ndërtuar do të thotë deri më tani prej atij prodhimi, por tani nuk po na duhet më, se ka kaluar në pronësi private dhe nuk po përkrahet.

Çka desha të shtoj? Do të thotë, në këtë drejtim, ju kisha lutur që t'i merrni parasysh aty ku mund të ndikoni, por jo asnjëherë duke shkelur cilësinë, se në rast se ne ndërtojmë diçka apo zhvillojmë diçka që nuk është cilësore, është e keqe. Ne tani pse e përmenda TVSH-në, jemi duke bërë një investim në Ferizaj po ashtu, në zonën ku gjendet Fabrika e... për përpunimin e konstruksionit metalik, ku do të prodhojmë profilet I, T, U... përpunimi i metalit, po për 20 vjetët e ardhshme me qenë në nivelin më të lartë, do të thotë se teknologjia më e re që tani për momentin ekziston, do të thotë, do të futet aty, por shpresoj që pastaj me projekte të mos jenë prapë të anashkaluar, se është keq. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Allajbeu, edhe njëherë.

KLODIAN ALLAJBEU:

Diçka të shkurtër. Çështja e licencave profesionale, duke ditur që në shëndetësi ka shumë nevojë për burime njerëzore të kualifikuara, përsëri do jap shembull. Në Shqipëri në 2005-ën ne deshëm, përsëri rreth 6 muaj deri në një vit të merrnim një licencë për një mjek që vinte dhe nga perëndimi, pasi u bë prezent situata, sot arrimë që për një mjek që vjen nga perëndimi, për një muaj merren të gjitha licencat, përfshi këtu nostrifikimin e diplomës, njohjen e specializimit dhe në fund, lejen e punës.

Kurse, megjithëse e kemi bërë prezent faktin, situatën në Ministrinë e Shëndetësisë, këtu është thjesht e pamundur. Me një fjalë, këtu të sjellësh mjekun nga Anglia, nga Gjermania... dhe është e pamundur ta punësosh. Me një fjalë, futesh në një ngatërresë të madhe, pret një vit të tërë, licenca të jepet për një vit, duhet të vërtetosh se nuk ka specialistë vendës, që mund ta bëjë atë punë, kur unë jam biznes privat dhe vendos unë në dua të marr dikë apo s'dua ta marr.

Dhe, ende vazhdon e njëjta gjë. Kur duhet të jetë një procedurë shumë e thjeshtë, ministria e linjës ngre një grup pune, udhëzon ndryshon udhëzimin administrativ në fuqi dhe, vazhdon

procedura. E njëjta gjë është për të importuar diçka, me një fjalë, të thuash që ka monopole që fuqizohen, ke materiale që ka nevojë tregu, në treg nuk i gjen, i sjellin me çanta nga Maqedonia të tjerët. Tani unë nuk e bëj dot atë, se bëj dot, s'i sjell dot me çanta, se s'e kam sistemin të tillë. Dhe, për këtë unë mbetem, ku normalisht, duhet të jetë shumë e thjeshtë.

Përsëri prodhimet perëndimore T, M... të certifikuara, nuk ke nevojë pse t'i regjistroshe çdo herë që i fut, ose të marrësh leje importi duke pritur Agjencinë e Barnave dhe të Materialeve, me një fjalë. Pret që të dalë leja e importit, sikur të futësh të gjithë në lutje, gjithë personelin që të na dali leja e importit. Me një fjalë, është diçka e panevojshme, që nuk është se them se ka dikush përfitim në këtë, por se thjeshtë ka mbetur në një procedurë të tillë dhe nuk evoluon. Dhe, kjo na e bën jetën shumë të vështirë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Alajbeu. Më duket drejtori i Doganave deshi të flasë, pastaj zonja Hashani.

LULZIM RAFUNA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Edhe unë isha sot faktikisht duke pritur, që të kemi pyetje ose të kemi kërkesa për procedura doganore, mirëpo meqenëse vetëm një ishte për garanci, sa i përket tjerave, s'kishte tjera kërkesa.

Unë atëherë, po e marr lirinë që këtu të shprehem në tri, në qoftë se mund t'i quaj rekomandime, ose komente, dy prej pozicionit tim si jurist, domethënë që e njoh dhe kam punuar shumë gjatë në këtë fushë. Është pikërisht që lidhet me këto licencat dhe me këto që kishte qenë mirë ta mendoni, në qoftë se ju e vlerësoni që të futet në ligj heshtja administrative, që në qoftë se një institucion apo agjenci brenda një kohe të caktuar, për shembull njëzetditore ose tridhjetë ditore nuk lëshon përgjigje, pavarësisht e refuzon apo e aprovon, të konsiderohet që është e aprovuar, domethënë se ligji i procedurës së përgjithshme administrative, në qoftë se brenda tridhjetë ditësh sot nuk i kthen palës përgjigjen, ta jep mundësinë për të shkuar në Gjykatë. Mirëpo, kjo i ndihmon shumë investitorit edhe krijon atë sigurinë juridike, që brenda tridhjetë ditësh do ta pranojë një kërkesë, domethënë një vendim, nuk është e rëndësishme e aprovon apo refuzon.

E dyta, prej përvojës sime, konsideroj që agjencia për promovimin e investimeve tash këtu që është i paraparë më ligj, duhet të jetë më... të luajë një rol më koordinues në mes pushtetit qendror dhe lokal, po të jetë edhe më kërkues por edhe të jetë përgjegjës për të raportuar të gjitha të metat në Qeveri, që ta njoftojë Qeverinë si institucion qendror, se kur po ngelë ose kush nuk po lëshon, ose kush po saboton, ose kush nuk po e kryen detyrën e vet, që ka obligim ta kryejë. Këto duhet patjetër të inkorporohen në ligj.

Sa i përket garancive, është shumë e vërtetë që në të gjitha takimet me investitorët e huaj na kanë shfaqur si pengesë, ose problem shumë të madh, se edhe Administrata Tatimore edhe Dogana në ligjet e veta kërkojnë që duhet të garantohet një borxh. Për shembull, në qoftë se një investitor vjen për ta investuar pajisjen 20 milionë, ai nuk mundet me një ngarkesë të vetme t'i sjellë, por i duhet një periudhë prej gjashtë ose shtatë muajsh, për t'i sjellë pjesë – pjesë. Edhe kodi neve na obligon, që në fillim, në vlerën e asaj pajisje që planifikohet të importohet, të sillet garancioni.

Në anën tjetër ai është një biznes i ri, që është regjistruar në Kosovë dhe banka nuk e njeh, nuk ka një histori në Kosovë ai biznes dhe këtu po na lindin problemet për ta sjellë garancinë, biznesi po mbetet, sepse s'po ka ku ta marrë garancinë, banka nuk po ia lëshon garancionin, se po i thotë, nuk ke një pasqyrë këtu në Kosovë.

Domethënë, edhe këtu është mirë të mendohet që të gjendet një zgjidhje për ta lehtësuar, se a mundet agjencia faktikisht, në emër të një biznesi që po vendoset në Kosovë, ta lëshojë një deklaratë, ose në njëfarë forme, me e gjet një mundësi, që agjencia edhe në këtë rast të ketë autorizime që të luajë një rol aty. Këto ishin, i nderuar kryetar. Unë jam i hapur prapë për çdo kërkesë, sa u përket procedurave doganore, të përgjigjem.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti drejtor! Zonja Hashani.

LUMNIJE HASHANI:

Ne e kemi edhe një kërkesë, sa i përket Gjykatës së Arbitrazhit, investitorit të huaj, gjithmonë në vendimet e veta, në kontratat e veta, hezitojnë ta fusin si klauzolë Gjykatën e Arbitrazhit e cila vepron në Kosovë, por e fusin klauzolën e gjykatave të Parisit dhe të Londrës.

Për këtë arsye, ne propozojmë që të bëjmë një fushatë sensibilizuese për investitorë të huaj, ndoshta së bashku të dalë si nismë nga ky dëgjim publik, së bashku me Agjencinë për promovimin e investimeve të huaja dhe me aktorë të tjerë, që të rritet kredibiliteti i Gjykatës së Arbitrazhit, e cila vepron në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëroni!

REXHEP BLLACA:

Unë vetëm do të përgjigjem në tri çështje që u ngritën si shqetësim. Neni 2 dhe 3 i Ligjit për investime të huaja e definon statusin juridik të investimeve të huaja në raport me investimet vendore. Investimet e huaja trajtohen në mënyrë të barabartë, do të thotë njëjtë si investimet vendore.

Arsyeja pse është quajtur Ligji për investimet e huaja, ne edhe kur e kemi draftuar Ligjin për investime të huaja e kemi pasur si problem këtë emërtim, mirëpo gjatë hulumtimit të emërtimeve të ligjeve, e kemi pa se edhe në shtetet - vendet tjera këtë ligj e quajnë ligji për investimet e huaja.

Arsyeja nuk është që këtyre investimeve të huaja duhet dhënë një trajtim shtesë ose trajtim më të favorshëm, mirëpo ekziston supozimi juridik, supozimi ligjor në të drejtën ndërkombëtare që shteti i mbron qytetarët dhe bizneset e veta. Nuk është kontestuese në të drejtën ndërkombëtare që shteti mos t'i mbrojë qytetarët dhe bizneset e veta.

Kontestuese në të drejtën ndërkombëtare është mbrojtja e investimeve të huaja dhe më tepër, për hir të perceptimit, ky ligj në Kosovë po edhe në vendet tjera quhet ligj për investime të huaja, por kjo assesi nuk prejudikon që investimet e huaja kanë përparësi apo favor të trajtohen ndryshe nga investimet vendore.

Megjithatë, për mua arsyeja është përmbajtja dhe zbatimi i praktik, dhe nëse vërtetohet të quhet ligji për investime, nuk është kurrfarë problemi.

Ndërsa, sa i përket rekomandimit tim për ta fuqizuar agjencinë, ideja ishte për ta fuqizuar me autorizime ligjore në mënyrë që agjencioni i përmendur po edhe drejtori i Doganës të kenë autorizime ligjore t'i kryejnë veprimet dhe me i nxjerrë të gjitha dokumentet, lejet e licencat me emër dhe llogari të institucionit. Kjo për dy arsye, për të lehtësuar biznesin dhe arsyeja e dytë është, sikur që u përmend këtu, korrupsioni dhe kjo do ta evitojë shumë korrupsionin për arsye se sipas raporteve ndërkombëtare çdo ballafaqim i palës, i biznesit me institucionin, çdo procedurë, çdo leje dhe i çdo licencë, është burim potencial i korrupsionit. Kështu që, nëse e evitojmë këtë ballafaqimin me përballjen e investitorëve dhe qytetarëve me institucionin, nëse na i kryejmë në emër të institucioneve të gjitha veprimet, atëherë kjo edhe shumë do të ndikojë lidhur me evitimin dhe luftimin e korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëroni, e ka fjalën zotëri Lekaj!

PAL LEKAJ:

Ajo që më erdhi mirë si propozim nga drejtori i Doganave, kishte me e lehtësuar mjaft punën me heshtjen administrative, sepse kjo është edhe në praktikë me leje të ndërtimit dhe nëse institucioni nuk e kthen përgjigjen, do të thotë mirret si pozitive, dhe kjo do t'i kishte të gjitha ato procedura që u përmendën.

Mirëpo, unë nuk pajtohem aq që mos të kemi kontroll nëse vjen edhe një ekspert nga jashtë, sepse ka ndodhur në Kosovë që kanë ardhur me profesorë – doktorë, tash të quajtur dhe fare s'kanë qenë mjekë të profileve të ndryshme. Prandaj, në këtë drejtim unë pajtoj që është jeta e pacientit dhe ne nuk guxojmë që të merremi pa e verifikuar mirë, meqë jam mjek me profesion dhe e di se si kanë vepruar edhe gjatë luftës dhe pas luftës. Dhe, po ua jap një shembull, pas luftës na kanë pru edhe kuadër të mesëm dhe kanë menduar se ne jemi ata që s'dimë çka është mjekësia, me zëvendësua mjekun nëpër qendra klinike apo diku tjetër.

Prandaj, në këtë drejtim, unë pajtoj që procedura të përshpejtohet, sikur që u tha, mirëpo kontrolli të jetë strikt dhe të mos shkojë në atë drejtim jo të duhur.

Sa i përket asaj që u tha të kemi një zyre. Drejt, dhe unë mendoj se ajo do të kishte të krijojë hapësirë për korrupsion, me krijuar një monopol, sepse çdo kund, praktika institucione që ka një hierarki vetëm vertikale dhe ka një qëndrueshmëri, e nuk e ka ndonjë horizontale të bashkëpunimit, mendoj se aty çdoherë lë hapësirë të korrupsionit.

Sa më tepër menaxhim i tërthortë dhe komunikim i tërthortë ndoshta aty ka procedura më të vështira, sepse nuk lejon që një njeri ta ketë vulën, por që ka shumë... dhe mendoj që ajo që ne duhet ta bëjmë plotësim-ndryshimin e ligjit, është që t'i heqim burokracitë që ndodhin apo edhe për mosefikasitetin e zyrtarëve tanë apo institucioneve. Kjo është! Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëroni!

BLERIM GRAINCA: Të shumtën, që desha ta them unë, e tha zoti Pal tani.

E, rrallë pajtohem me opozitën por kësaj here ia kanë qëllue!? Në funksion të bizneseve dhe të lehtësimit të heqjes së barrierave, do të thotë gjithsesi duhet të jemi bashkë edhe opozita dhe pozita, të gjitha institucionet.

Në këtë rast edhe unë kam për të thënë, se e ndaj dhe realisht e kam një mendim të kundërt me propozimin që vjen nga KIESA për t'i dhënë kompetenca që mund të kryejë shërbime, të quaj, të konsulencës për komunitetin e biznesit, sepse vetë roli i KIESA-s është promovimi, shpërndarja e informatave dhe assesit futja në marrëdhënie partneriteti me komunitetin e biznesit. Ndoshta ne e kemi diskutuar që si propozim KIESA të kalojë si zyre në kompetencë të zyrës së kryeministrit, do të thotë të hiqet nga MTI, të kalojë direktë dhe raportojë Zyrës së kryeministrit dhe pastaj të ketë fuqi më të mëdha ekzekutive, të themi, për kryerje të punëve ditore, por mendoj se do të ishte konflikt nëse KIESA do të kryente edhe shërbime tjera jashtë mandatit ligjor që ka në favor të bizneseve, sepse në atë rast do të vlente, apo dyshohet se do të ishte ajo adresa e vetme, siç thotë edhe INDP, nga shumë adresa, e të gjitha shigjetat të shkonin pastaj te KIESA.

Do të thotë, kjo është ideja edhe që do ta diskutojmë. Mos ta marrim si polemikë por si diskutim.

AVNI KASTRATI:

Po mundohem edhe unë shumë konkretisht të kontribuoj. Deri sa kam qenë kryetar komune në Mitrovicë, na e dimë që Mitrovica, Prizreni dhe Gjakova kanë qenë të shpallura si zona të lira ekonomike, dhe me vendimin e Qeverisë ka qenë formulimi i atillë që thotë se – tërë zona kadastrave e qytetit, është zonë e lirë ekonomike që në realitet nuk mund, si thonë, të jetësohet për arsye se të gjithë ne e dimë, por edhe drejtori i Doganave që është këtu. Prandaj, kisha lutur që kur të bëhen revidime të kemi kujdes, do të thotë, në këtë shprehje, të mos mendohet se tërë qytetet janë zona të lira ekonomike ose të definohet për të mos jetë situata që ata që janë të interesuar për të investuar, t'i kuptojnë ndryshe, ashtu qysh shkruan.

E dyta, prej të gjitha kontakteve që kam pasur deri tash, mundësia më e madhe për një zhvillim ekonomik është pikërisht kërkesa e bizneseve që të jenë, do të thotë, pjesë e zonave të lira ekonomike. Dihet pse! Nuk ka nevojë të komentohet. Prandaj, po ashtu e kisha dhënë një lutje se diku në ato ligje ose në projeksionet buxhetore për tutje, duke ia filluar prej rishikimit që ndoshta ndodhë, do të thotë, pas qershorit, të kemi kujdes se zonat e lira ekonomike t'i kompletojmë me infrastrukturë, sepse sipas bisedës, do të thotë, me investorët potencialë, nëse nuk ka infrastrukturë është shumë vështirë me hy aty.

Dhe, e treta. Me pas kujdes, mirë të definohet, se si mund të merret e drejta për menaxhim me zonë të lirë ekonomike, mos të ndodhë që t'i jepet dikujt, e ai pastaj duke pa interesin e vet të jetë faktor limitues që të tjerët mos të hyjnë brenda.

Për këto tri elemente do të ju kisha lutur dhe njëkohësisht edhe për zotin deputet Enver Hotin dhe tjerët, i kisha lutur që ne bashkërisht të shohim, do të thotë, t'i bëjmë zgjedhjet më të mira të mundshme, sepse ne jemi ata që duhet zbatuar ligjin e ju jeni ata që e bini ligjin, prandaj nëse bini ligj të mirë ne do ta zbatojmë ashtu sikur që e bini.

Me këtë po dua të them se secili prej nesh duhet të këqyrë çka mund të kontribuojmë, duke pasur kontakt me komunitetin, qoftë bizneset familjare, biznesin në regjion, e tjera, e tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zotëri Rafuna!

LULZIM RAFUNA:

Faleminderit kryetar! Unë vetëm desha ta sqaroj atë idenë time, të dytën, sa i përket agjencionit. Unë e mendova ta luan rolin e koordinatorit apo të koordinimit, por jo të jetë vendimmarrës sepse paraqet probleme pastaj në ndërhyrje të kompetencave.

Unë thashë, vetëm rolin e koordinatorit ta ketë e të shohë pse s'po e lëshon një institucion një certifikatë, pse një procedurë në doganë, për shembull, ka mbet me muaj të tërë dhe me atë rast të jetë i obliguar me ligj të raportojë Qeverinë që të ndërmerren masa ndaj atyre zyrtarëve ose ndaj atij institucioni. Pra, këtë desha ta sqaroj, që të mos keqkuptohemi!

KRYESUESI:

Faleminderit!

Për tu ndërlidhur me këtë çka u tha, ne në takimet të cilat i kemi pas edhe me KIESA-n edhe me Ministrinë, po edhe me biznesin, dua të jem shumë i hapur me juve – kemi shumë vërejtje në punën e funksionalitetit të KIESA-s.

Vërejtjet shkojnë prej natyrave teknike deri tek funksionaliteti i tyre dhe efektet të cilat arrihen në tërheqjen e investimeve. Pra, mbi këtë bazë ne do të dalim edhe me rekomandimet tona dhe një nga rekomandimet ka qenë, e kjo është diskutuar edhe më herët dhe unë besoj që është edhe në plan, meqenëse kam punuar edhe personalisht në një pjesë të mirë të planit të Qeveris dhe në Plan të Qeverisë është që agjencioni duhet të jetë në kuadër të Zyrës së kryeministrit për shkak të një vertikaliteti që duhet të funksionojë dhe të ketë njëfarë supremacie, nëse mund ta quaj, në raport me institucionet të cilat duhet të japin çfarëdo lloj lejesh apo të cilat duhet të kenë më shumë autoritet, por ky autoritet duhet të pajiset me punë. Ky autoritet nuk mund të jepet vetëm me letra, mirëpo autoriteti duhet të pajiset me punë konkrete. Me punë konkrete, po e zëmë, në regjistrimin e problemeve, unë kam kërkuar personalisht nga agjencia që të na vijnë me një listë propozimet çfarë këta kanë hasur problematikë gjatë realizimit të ligjit dhe mbi ato propozime ne pastaj të ndërrohem, sepse këta janë hapi i parë që parimisht konform ligjit duhet ta kenë në komunikimin e parë me investitorët potencialë. Dhe jo, në asnjë rrethanë, mos me u dhënë kompetencave dhe unë nuk jam për dhënie të kompetencave në asnjë rrethanë operative në emër të dikujt tjetër sepse këta nuk mund të operojnë në emër të dikujt tjetër. Pra, mendoj se këtu ishte ajo, sepse tjetër është koordinimi e tjetër është veprimi në emër të dikujt dhe për llogari të dikujt tjetër. Pra, në asnjë rrethanë sepse ky atëherë do të jetë konflikt i hapur i drejtpërdrejtë në aspektin e fuqizimit administrativ dhe mundësisë së keqpërdorimeve në këtë drejtim.

Ajo çka ne gjatë këtyre ditëve, do të thotë, unë u mundova ta bëjë njëfarë përmbledhje të gjitha gjërave dhe rekomandimeve që kanë dalë është se është kërkuar që në të gjitha takimet që i kemi pasur me bizneset vendimi për heqjen e pushimeve apo pushimet nga taksat edhe heqjen e TVSH-ës nëpërmjet hyrjeve kufitare që ka qenë kërkesë në Odën Ekonomike decidive dhe nga Oda Ekonomike Amerikane të jenë procedura të cilat duhet të përshpejtohen shumë shpejt. Pra,

është një rekomandim themelor i cili mund të ketë ndikim të drejtpërdrejt në tërheqjen e investimeve të huaja.

Dhe, kërkesa tjetër që ka dalë, e që u tha edhe këtu, është që të hiqet TVSH e dogana dhe t'i jepet prioritet prodhimit vendor. Pra, aty flasim për lëndë të parë dhe për pajisje.

Duke qenë për dy vite gati ministër i financave, e di që një numër i madh e mos të them mbi 90% të pajisjeve dhe të lëndës së parë janë të hequra si taksa, por që ka nevojë edhe më tutje këto të përmirësohen. Dhe duke marrë parasysh se ne kemi bërë një ligj më herët, i cili ka ndejt në Kuvend gati një vit e gjysmë, kur dogana dhe taksat e akcizës duhet të hiqeshin me ligj të veçantë nga Kuvendi, ne vitin e kaluar e kemi aprovuar një ligj i cili mundëson që me një vendim të Qeverisë dhe me një njoftim të Komisionit për buxhet e financa bizneseve tu hiqen në mënyrë automatike të gjitha ato taksa të cilat janë të nevojshme në bazë një analize që duhet ta bëjë investitori, KIESA dhe agjencia. Pra, këto janë gjëra me të cilat duhet të veprohet dhe kjo është çështje jave, nuk është më çështje më çështje as muajsh as vitesh. Pra, kjo duhet të jetë funksionale. Kjo duhet të bëhet realizim, të themi, i një analize të plotfuqishme i çfarëdo investimi i cili duhej të vjen dhe të reagojmë shpejt sepse kështu reagon e tërë bota.

Sigurimet. Për çështjen e depove prodhuese, nëse mund t'i quaj, dhe depove tregtare, ne atëherë e kemi zgjedh më herët një proces të tillë por që kjo çështje besoj se mund të zgjidhet në bazë edhe të propozimit që e bëri drejtori i doganave nëse kemi një bashkëpunim më të fuqishëm në mes të KIESA-s dhe këtyre, në një formë, të një deklarate por jo marrje të obligimeve, sepse KIESA nuk mund të marrë obligime në asnjë rrethanë për askend.

E kemi një problem tjetër i cili na është paraqitur dhe është regjistrimi i punonjësve. E përmendi edhe zoti Allajbeu mirëpo kemi raste të shumta të bizneseve që na i kanë thënë atëherë edhe në OKB, edhe me investorët tjerë kur kemi komunikuar që regjistrimi është goxha i komplikuar. Për atë arsye ne edhe i kemi ftuar sot por nuk po e shoh se ka ardhur dikush nga divizioni apo departamenti për migrim, i cili procedurat i ka tmerrësisht sipas asaj çfarë neve na është raportuar nga biznesi, të gjata dhe të cilat, nganjëherë mund edhe të keqpërdoren.

Mirëpo, ne kemi kërkuar se a ka keqpërdorim edhe nga ana tjetër, sepse neve na intereson të dimë edhe keqpërdorimet nga ana e investorëve. A ka rrezikshmëri dhe cila është rrezikshmëria që dikush të sjell punëtorë të cilët nuk punojnë. Kjo ishte ajo që e tha edhe deputeti, apo me falsifikim të dokumentacionit, por që realisht është një procedurë e cila është tepër e komplikuar.

Ajo që është thënë dhe po vazhdon të thuhet, është funksionimi i rendit dhe ligjit, që në bazë të analizave që ne i kemi bërë kjo është pika më e ndjeshme, më problematike për tërheqjen e investimeve të huaja, është zbatueshmëria e kontratave, është parashikueshmëria e biznesit.

Dhe nëse flasim për investimet të cilat janë bërë, që u përmend këtu edhe rasti i spitalit, nuk ka mundësi që në një spital të bëhet investimi apo i një çfarëdo investimi të bëhen investime me miliona dhe tash në fazën e fundit të jepet apo të mos jepet. Ai nëse ka probleme ligjore, duhet të ndalet në start.

Pra, zbatimi i kontratave si duket është një problem themelor për të cilin ne do t'i raportojmë Kuvendit dhe do të kërkojmë që ky zbatim i kontratave, qoftë edhe vendosja e klauzulave nëpër kontrata të arbitrazhit vendor, i cili është bërë me eksperiencë ndërkombëtare dhe besoj që janë ekstremë të mirë, edhe në Odën Ekonomike edhe në Odën Amerikane, duhet më shumë t'i shfrytëzojmë si të tillë.

Licencimi, apo moslejimi i investitorëve, në rast se nuk plotësohen kushtet, së paku unë kështu e nxjerra njëfarë konkluzioni. Ne nuk dëshirojmë të prejudikojmë a duhet a s'duhet me ia dhënë dikujt një licencë. Atë e vendosin institucionet përgjegjëse, por në rast se kjo nuk i ka dhe nuk i plotëson... atëherë duhet të ndalet me kohë dhe jo të dëmtohen palët, sepse ne mund të rrezikojmë dhe këtë e them shumë hapur – mund të rrezikojmë kontestet shumë të fuqishme gjyqësore të cilat mund të vijnë me padë për buxhetin e shtetit dhe këto janë të ndara si kolaterale të mëvonshme.

Prandaj, në këtë drejti ndoshta edhe heqja administrative, sikur ka qenë te lejet e ndërtimit... e dini se sa është debatuar për leje të ndërtimit më herët, kjo ka qenë një nga zgjedhjet e mia dhe besoj që ishte një propozim goxha i mirë.

Te hartimi i projektit që u ngrit atje. Besoj se kjo është çështje që drejtpërdrejt duhet të adresohet tek prokurimi dhe prokurimi i cili realisht bën propozimin e projekteve, por ajo çka unë dua të them është që ne të jemi shumë më të koncentruar me gjëra të cilat na paraqiten në përditshmërinë dhe ato t'i themi, t'i themi hapur. Edhe nëse ka predispozitë, për shembull, le të shkojë dhe të kontaktohet KIESA nëse një investitor i cili ka për të investuar dhe sheh se është në përshkrimin e dokumenteve të tenderimit dhe diçka nuk është në rregull, duhet shkuar dhe komunikuar me ta edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse ligji për investime e obligon KIESA-n t'i mbrojë investimet e huaja. E obligon, dhe në parim, për emrin e ligjit për të cilin foli edhe Rexhepi, ndoshta goxha ka rezon logjik atë që e tha drejtori ligjor, por që ne në kuptimin kur flasim për investime duhet tu japim edhe përfshirje ligjore të përgjithshme, do të thotë, jo vetëm të kemi një fokus, sepse investimet e huaja nuk na vijnë nëse s'ka investime vendore dhe nuk trajtohen ato mirë.

Pra, këto janë disa gjëra për të cilat ne do të dalim me rekomandime dhe besoj që javën e ardhshme do ta thërrasim edhe ministren sepse ka involvim politik të politikave qeverisëse të cilat duhet të bëhen dhe duhet të jetë edhe ajo në ngjarje me të gjitha këto çka janë kah ndodhin, por që rekomandimet tona do të shkojnë në tri orientime.

Orientimi për ligjin aktual, a ka probleme në zbatueshmëri apo nuk ka probleme, i cili është reaksion i drejtpërdrejt i mbikëqyrjes të cilën ne e kemi bërë. Për politikat qeveritare do ta bëjmë një rekomandim tjetër i cili prapë do të jetë në kuadër të komisionit tonë, por që do të jetë rekomandim me politika dhe për këtë arsye na vyen edhe prezenca e ministres në këtë debat të mëvonshëm sepse lidhet me veprime shtesë të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë tek investimet. Dhe pjesa tjetër, është te politikat fiskale, respektivisht funksionimi i rendit dhe ligjit, që janë gjëra operative për të cilat duhet të merret ekzekutivi në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Këto janë pra në parim një lloj përmbledhjeje e asaj çka është diskutuar jo vetëm sot këtu, por është diskutuar edhe më herët në të gjitha takimet që i kemi pasur dhe dua të them, si deputet, që

ne jemi të interesuar që ato ligje të mos jenë ligje laboratorike por ligje të zbatueshme, ligje të cilat fundi i fundit, i bien për shtati.

Dhe një propozim i cili më iku më herët, e që ka ardhur atë ditë nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe që e përmendi edhe zonja Hashani, është se komuniteti i biznesit në njëfarë forme duhet të gjejë modalitet dhe jo vetëm të jetë prezent nëpër dëgjime publike por duhet obligativisht çdo ligj ekonomik të kalojë nëpër duart e komunitetit të biznesit paraprakisht, por kjo kërkon angazhim maksimal të asociacionit të biznesit.

Ne nuk jemi sot të kënaqur me praninë e komunitetit të biznesit, nuk jemi të kënaqur me praninë e asociacionit të biznesit, sepse në takimet që i kemi pasur atje kanë dalë shumë gjëra të cilat do të ishin shumë më të fuqishme t'i thonë prapë këtu në debat. Sigurisht se kanë pasur agjenda tjera, por do të ishte më mirë që ta promovojnë pak edhe te anëtarët e jo të flasin vetëm administrativisht si asociacione të tilla. Pra, ne kërkojmë që komuniteti i biznesit të jetë aktiv në proces të draftimit e jo të kemi reaksion pas aprovimit të ligjeve, sepse kjo është realisht ajo çka po na ndodhë shpesh.

E kemi zotin Pacolli, dhe nëse nuk kemi shumë, kishim për ta përmbyllur sepse tash jemi në përsëritje të gjërave. Urdhëroni!

ISLAM PACOLLI:

Kryesues, faleminderit!

Po më vjen shumë mirë që e ke marrë këtë, për arsye se je njohës i ekonomisë. Jo, të vetmen për arsye se nga doganat asnjëherë nuk kemi pasur një vërejtje më të vogël rreth tjera funksionimeve, përveç kësaj, do të thotë, sa i përket depove të doganave, dhe përgjigja nuk ishte konkrete për arsye se është vendimi nga Banka Qendrore që i trajton edhe depot doganore për prodhues dhe tregtarët, dhe nuk i ndanë.

Edhe unë isha shumë konkret. Si mund ti ta përkrahësh do të thotë tregtarin, kur ti e përkrah një prodhim jashtë vendit tënd, kurse nuk e përkrah prodhimin vendor. Dhe këtu, nëse në thonjëza po them “ka ndonjë kompani problem me këto çështje”, apo mos janë cenuar drejtpërsëdrejti kompania e caktuar, por jo të gjithë prodhuesit.

Prapë po e ceku, prodhuesi duhet të jetë i shenjtë, duhet të përkrahet jo në mënyra ligjore e jashtë ligjit por në formën ligjore dhe duke i plotësuar të gjitha kriteret.

Banka Qendrore e ka lëshuar vendimin por arsyen pse pastaj nuk është marrë parasysh nga drejtorja e doganës nuk e di, sigurisht drejtori do të na e thotë, të vetmen kërkesë këtë e kam nga dogana. Faleminderit!

KRYESUESI: Edhe drejtori le të marrë fjalën dhe pastaj, nëse s'keni diçka tjetër, e kisha përmbyllur.

LULZIM RAFUNA:

OK! Faleminderit kryesues!

I nderuar zoti Pacolli, ne për herë të parë me garancion e kemi filluar vitin e kaluar në mes të vitit, faktikisht ka qenë muaji qershor ose korrik që kemi filluar për arsye se janë shumë

procedura dhe ne kemi filluar me procedurën e depos doganore dhe ky ka qenë teksti i parë për kompanitë e sigurimeve që kanë filluar të lëshojnë garancione.

Ne duke pasur parasysh se inkasojmë ose mbledhim për 75% nivel të taksave për buxhetin e shtetit kjo po na shtyn që të jemi shumë të kujdesshëm edhe në procedurat që mos të na dalin probleme, duke pasur parasysh edhe procedurën gjyqësore që te ne marrin shumë kohë deri sa ta realizojmë atë borxh, kështu që ne do të vazhdojmë, do të vazhdojmë edhe me procedura tjera dhe do të shkojmë hap pas hapi faktikisht, por jo përnjëherë por do të shkojmë shumë sigurt dhe hap pas hapi që do të jetë mirë edhe për biznesin por edhe për doganën.

KRYESUESI: Faleminderit! Nëse s'keni diçka tjetër, ju falënderoj të gjithëve dhe do të njiheni me rekomandimet të cilat do t'i bëjmë për Kuvendin. Ju faleminderit shumë!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim